



Datë: 24.12.2025

Numër Protokolli: 8082/2025

A.nr.1644/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1644/2025, të datës 01.09.2025, të parashtruar nga ankuesi H.V, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Prenk Pepaj nga Gjakova, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, , me datë 24.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1644/2025, e datës 01.09.2025, e parashtruar nga ankuesi H.V.

II. Mbetet në fuqi Akt Emërimi me numër Reference: DSP-563/2025, i datës 22.07.2025.

A r s y e t i m

Ankuesi H.V, (tutje ankuesi), përmes postës më datë 25.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 01.09.2025, e regjistruar nën shenjën A.nr.1644/2025, kundër Akt Emërimit me numër Reference DS-563/2025 të datës 22.07.2025, lidhur me caktimin e pozitës me mandat katër (4) vjeçar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje SKGJK), ndërsa, ky i fundit, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5811/2025 të datës 01.09.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 21.08.2025; Plotësimin e ankesës; Akt Emërimin me numër Reference: DS-563/2025 të datës 22.07.2025; Akt Emërimin e datës 28.12.2012 dhe datës 07.04.2014; Kërkesën për përgjigje në ankesë 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 29.09.2025; Akt Emërimin me numër Reference: DS-512/2024, të datës 01.07.2024; Emaillet e datës 27.07.2025 nga B.G, për nëpunësit e SKGJK.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses nuk është e bazuar, *sepse*:

Vlerësimi gjendjes së fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- ankuesi sipas Akt Emërimit me numër Reference: DS-512/2024, të datës 01.07.2024, ka mbajtur pozitën Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në kuadër të SKGJK.

-pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, më datë 22.07.2025, ka përgatitur Akt Emërimit me numër Reference: DS-563/2025, për pozitën e njëjtë me mandat katër (4) vjeçar, më efekt të rrjedhjes së mandatit nga data 17.06.2025, ku të njëjtin ankuesi e nënshkrua pa vërejtje.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se me akt emërimit të datës 22.07.2025, ka ndryshuar marrëdhëniet e punës respektivisht është cenuar siguria e marrëdhënies së punës, ngase përcaktimin i pozitave udhëheqëse si pozitë me mandat nga ato të karrierës cenon qëndrueshmërinë e shërbimit civil dhe pritshmëritë legjitime e në këtë rast janë shkelur parimet e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse kjo ka qenë një e drejtë e fituar dhe akt emërimi i kundërshtuar është në kundërshtim me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të emërohet në pozitë më kohë të pacaktuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të statusit ligjor të të punësuarve në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenin 2 paragrafi 3, ku përcaktohet: *3. Për nëpunësit/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”, si dhe nenit 6 paragrafi 4 ku përcaktohet: *Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë*, e për rrjedhojë, kolegji konstaton se të punësuar në SKGK janë nëpunës civil me status të veçantë, duke nënkuptuar së marrëdhëniet e punës, rrjedhimisht të drejtat dhe detyrimet përkitazi me marrëdhënien e punës rregullohet në pajtim me parimet e këtij ligj dhe akt të veçantë ligjor.

Në kuptim të përcaktimit si më sipër, si dhe nisur nga pretendimi ankimor lidhur me kufizimin kohor të pozitës së ankuesit (më mandat), Kolegji i Këshillit duke iu referuar nenit 46, paragrafi 1 dhe neni 49, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë rithekson faktin se pozitë drejtuese janë pozita më mandat katër (4) vjeçar me të drejtë vazhdimi edhe një mandat katër (4) vjeçar, me kushtin që janë respektuar kërkesat dhe procedura e pacaktuar më ligj. Ndërsa, referuar nenit 18, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në fuqi nga data 17 qershor 2025, është përcaktuar: *3. Nëpunësit civil të emëruar në pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese para hyrjes në fuqi të ligjit bazik konsiderohet se fillojnë mandatin e parë me hyrjen*

në fuqi të këtij ligji. Pra, nëpunësit civil të kanë qenë të emëruar në pozitë të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues para hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet së fillojnë mandatin e tyre të parë në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Rrjedhimisht, në kontest të vendimmarrjes së drejtë dhe meritore lidhur më çështjen ankimore, Kolegji i Këshillit po ashtu mori parasysh edhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sipas Aktgjyimit për rastet nr. KO222/24 dhe KO224/24, me theks të veçantë pikën 153 të aktgjyimit ku citojmë”. Bazuar në vlerësimin dhe konstatimin si më lart, Gjykata konsideron se paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar ua garantojnë nëpunësve civilë të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, të cilët aktualisht mbajnë pozita me mandat të pacaktuar, pavarësisht nëse në momentin e emërimit të tyre në pozita me mandat të pacaktuar, kanë qenë ose jo pjesë e shërbimit civil, minimalisht një mandat 4 (katër) vjeçar që fillon nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me mundësi vazhdimi edhe të një mandati tjetër 4 (katër) vjeçar, me kusht që të njëjtit e arrijnë vlerësimin “arrin pritshmëritë”. Në rast të (i) mosvazhdimit të mandatit të parë kur nuk arrijnë vlerësimin “arrin pritshmëritë”; ose (ii) mospërzgjedhjes pas përfundimit të mandatit të dytë; ose (iii) moskonkurrimit për pozitën që e kanë mbajtur, Ligji i kontestuar ua garanton marrëdhënien e punës nëpunësve civilë të kësaj kategorie duke i sistemuar në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale. Në leximin e përbashkët të dispozitave relevante të Ligjit bazik dhe atij të kontestuar, Gjykata, rithekson se nëpunësit civilë të afektuar nga ky ligj ruajnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil pa përfshirë në listën e pritjes sipas nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të plotësuar dhe ndryshuar përmes nenit 12 të Ligjit të kontestuar. 154. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar janë në pajtueshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. 155. Bazuar në konstatimin e Gjykatës që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 të Ligjit të kontestuar nuk janë në kundërshtim me të drejtat pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se përcaktimet përmes këtyre dispozitave, nuk bien në kundërshtim me të gjeturat e Aktgjyimit të saj në rastet KO216/22 dhe KO220/22, ndërsa në dispozitiv të këtij aktgjykimi respektivisht pikën II është vendosur: **II. TË KONSTATOJË, që paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 18 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

Andaj, referuar konstatimeve si më sipër, Kolegji vlerëson së akti administrativ i kontestuar më ankesë gjegjësisht akt emërimi me Reference: DS-563/2025, i datës 22.07.2025, është akt i nxjerrë në pajtim më nenin 18, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, kështu që, pretendimet e ankuesit për kthim të mandatit sipas akt emërimit paraprak janë të pabazuara.

Thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1644/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankeusit Avokat Prenk Pepaj;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.